



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1092/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nerxhivane Vitija, kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Prishtinë, për shkak të vjedhjes së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Nerxhivane Vitija kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik (AKR) dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Nerxhivane Vitija, kandidate për anëtare të kuvendit komunale nga radhët e subjektit politik (AKR) dega në Prishtinë, ku theksohet se ankesa e saj bëhet në mes të vjedhjes brenda partiake dhe QNR: ShF.Pjetër Bogdani – 9 vota, Kl.IV (komplet familja ime), ShM. Sami Frashëri – 8 vota (familja Brosha), Shf.Meto Bajraktari – 6 vota, ShF.Elena Xhika – 4 vota (Osman Vitia), ShF. Ismail Qemalli- 4 vota, ShF. Shkëndija Ajvali – 8 vota (familja Haxholli), ShF. Iliria – 4 vota, Fakulteti Ekonomi- 5 vota, Emin Duraku – 8 vota (familja Kuqi), Shtefan Gjeqovi – 3 vota (familja Vitia), Fak.Ekonomik – 2 vota (Hamdi Gashi).

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtrueses së ankesës Nerxhivane Vitija kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga AKR, se i janë vjedhur votat brenda partiake dhe QNR-së, PZAP-i i vlerëson si pabazura dhe të pa argumentuara me prova dhe dëshmi, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, nga arsyeja se pretenduesja nuk ka bashkangjitur asnjë provë me të cilat do të dëshmojë se i janë vjedhur votat po ashtu nuk i ka precizuar numrin e votave se sa duhet ti ketë dhe se sa i janë vjedhur votat , andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së,si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1092/2013 më datën 06.12.2013

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



Këshillë Juridike:

Ndaj ketij vendimi mund te paraqitni ankese ne Gjykatën Supreme te Republikës se Kosovës Brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes se vendimit nga PZAP-i.